DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
440 N. BROAD STREET – 2nd Floor, Suite 206
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

ZYRA E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA **SHËRBIMET SHENDETËSORE TË SHKOLLËS**
(215)400-6004
FAX: (215)400-4173

Mësimi që Zhvillohet në Shtëpi

I dashur Prind/Kujdestar:

Qëllimi i Mësimit që Zhvillohet në Shtëpi, është që t'i ofrohen nxënësit disa nivele shërbimesh mësimore, gjatë një periudhe të përkohëshme mungesash, në mënyrë qe ai të mos mbetet prapa programit mësimor, kur të riaftësohet. Mësimi që Zhvillohet në Shtëpi nuk ka qëllim dhe as nuk është krijuar si metodë për mësim të plotë dhe nuk përmban kreditet e mjaftueshme për kalimin e klasës. Mësimit që Zhvillohet në Shtëpi nuk është zëvendësim për mungesat në shkollë. Mësimit që Zhvillohet në Shtëpi duhet të përdoret si mundësia e fundit pas përdorimit të të gjithë mundësive alternative të tjera (p.sh gjysëm ditë mësim, paketa punësh etj).

- Mësimi që Zhvillohet në Shtëpi është një shërbim që Drejtoria Arsimore e Filadelfias mund ta ofrojë gjatë një periudhe mungesash të arsyeshme për raste mjeksore akute më së paku 4 javë dhe jo më shumë se tre muaj, sipas kërkesave të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë.
- Mësimi që Zhvillohet në Shtëpi mund të ofrohet periodikisht në periudha të shkurtëra kur përsëriten mungesat për shkak të acarimit të një sëmundjeje kronike (kërkohet nga mjeku me shkrim). Nxënësi duhet të vijë në shkollë, kur gjendja e sëmundjes përmirësohet. Miratimi për Mësimin që Zhvillohet në Shtëpi jepet për periudhën e një viti shkollor dhe përfundon në fund të çdo viti shkollor.
-

Prindi/kujdestari i nxënësit aplikon për Mësimin që Zhvillohet në Shtëpi, pasi të ketë të plotësuar formularin e referencës së mjekut, firmën e specialistit që e trajton nxënësin, që i dorëzon te infermieri i shkollës. **Referenca e mjekut nuk do të pranohet nga Drejtoria Arsimore, në rast se nuk jepen shpjegime për mungesat. Prindi/kujdestari kenë të drejtën që të ruajnë fshehtësinë e informacionit mjekësor; megjithatë kjo mbajtje e fshehtë mund të çojë në përfundimin e shërbimeve në shtëpi. Në rast kur konditat mjekësore kërkojnë shërbime në shtëpi për më shumë se tre muaj, ju duhet të plotësoni një referencë të re nga mjeku, përpara se aplikimi fillestar të përfundojë.** Në rast se referenca e re mjekësore nuk është gati, Mësimi që Zhvillohet në Shtëpi do të pezullohet dhe fëmijës tuaj do t'i numërohen mungesat.
Suksesi i Mësimit që Zhvillohet në Shtëpi dhe progresi i fëmijës do të varen nga kooperimi i fëmijës, mësuesi i shërbimit në shtëpi dhe prindi/kujdestari. Me miratimin e Mësimit që Zhvillohet në Shtëpi, prindi/kujdestari duhet t'i përmbahet marrëveshjeve të mëposhtëme:

- Ofrojë një mjedis të pastër, të ndriçuar dhe me temperaturë të përshtatëshme për mësuesin dhe nxënësin.
- Gjatë gjithë periudhës së mësimit në dhomë duhet të jetë i pranishëm një i rritur nga familja.
- Nxënësi duhet të jetë i veshur si duhet dhe i gatshëm për mësim me ardhjen e mësuesit.
- Gjatë gjithë periudhës së mësimit në dhomë duhet që të mbahet qetësi dhe të mos ketë shqetësime nga Tv, radio, fëmijë të vegjël dhe kafshë shtëpiake.
- Njoftoni mësuesin para orës 8:30 AM, në rast se nxënësi nuk ndjehet i aftë për mësim, ose kur një person tjetër në shtëpi ka sëmundje ngjitëse.
- Firmosni formularin e mësuesit në përfundim të çdo seance mësimore.
- Rregulloni kur është e mundur oraret e vizitave te doktori, terapinë etj., që të mos ketë përplasje me orarin e mësimit.
- Mos plotësimi i konditave si më lart, mund të rezultojë në përfundimin e mësimit në shtëpi.

Unë i lexova dhe jam dakord me kërkesat për Mësimin që Zhvillohet në Shtëpi për fëmijën tim. Unë do të ofroj mjedis mësimor të kënaqshëm, që të arrij maksimumin e potencialeve mësimore të fëmijës tim.

FIRMA E PRINDIT/KUJDESTARIT_____ DATA_____

ADRESA_____ NUMRI TELEFONIT_____

EMRI I NXENESIT:_____ SHKOLLA:_____ KLASA:_____

• One (1) copy to Parent/Guardian
• One (1) copy to be kept in the homebound student's file at school
• One (1) copy to the Homebound teacher